

SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME SHA
Pasqyrat Financiare
për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022



1. INFORMACION I PËRGJITHSHËM

Në mbështetje të ligjit nr.9901, datë 14.04.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, në vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 302, datë 11.05.2022 “Politikat Kombëtare për riorganizimin e sektorit të furnizimit me ujë dhe të largimit, trajtimit dhe pëpunimit të ujerave të ndotura”, Marrëveshjes për Krijimin e Shoqërisë Rajonale Ujësjetles Kanalizime Elbasan Sh.A, të lidhur midis Bashkive Elbasan, Librazhd, Peqin, Cërrik, Belsh, Gramsh dhe Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë datë 22.07.2022, është krijuar Shoqëria “SHOQERIA RAJONALE UJESJELLES KANALIZIME” SHA e regjistruar pranë Drejtorisë Rajonale Tatimore Elbasante me NIPT M23322201V ka për aktivitet

- a) Sherbimi i furnizimit me uje te pijshem i konsumatoreve dhe shitja e tij;
 - b) Mirembajtja e sistemit/sistemeve te furnizimit me uje te pijshem;
 - c) Prodhimi dhe/ose blerja e ujit per plotesimin e kerkeses se konsumatoreve;
 - c) Sherbimi i grumbullimit, largimit dhe trajtimit te ujerave te ndotura;
 - d) Mirembajtja e sistemeve te ujerave te ndotura, si dhe te impianteve te pastrimit te tyre. Shoqëria duhet të realizojë çdo lloj operacioni financiar apo tregtar që lidhet direkt apo indirekt me objektin e saj, brenda kufijve të parashikuar nga legjislacioni në fuqi.
- Shoqëria ushtron veprimtarinë e saj në përputhje me lejet, autorizimet, licencat sipas legjislacionit në fuqi. Administratori i shoqërisë Z. Luan Tabaku.

Kapitali i Shoqërisë është i përbërë nga:

- 51% Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë
- 5.46% Bashkia Cërrik
- 4.13% Bashkia Gramsh
- 28.52% Bashkia Elbasan
- 3.34% Bashkia Peqin
- 4.42% Bashkia Belsh
- 3.13% Bashkia Librazhd

2. BAZAT E PËRGATITJES

2.1 Deklaratat e përputhshmërisë

Pasqyrat financiare janë përgatitur në përputhje me Standardet Kombëtare të Kontabilitetit (“SKK”).

2.2 Bazat e matjes


Pasqyrat financiare janë përgatitur sipas parimit të koston historike. Këto pasqyra financiare janë përgatitur dhe paraqitur në Lekun shqiptar (“Lek”), rumbullakosur në mijëshen më të afërt. Leku shqiptar është monedha funksionale dhe paraqites për Shoqërinë.

2.3 Vlerësime dhe gjykime

Përgatitja e pasqyrave financiare kërkon që Drejtimi të bëjë gjykime, vlerësime dhe supozime që ndikojnë zbatimin e politikave kontabël dhe në shumat e raportuara të aktiveve, detyrimeve, të ardhurave dhe shpenzimeve. Rezultatet aktuale mund të ndryshojnë nga këto vlerësime.

Vlerësimet dhe gjykimet rishikohen në mënyrë të vazhdueshme. Rishikimet e vlerësimeve kontabël janë të njohura në periudhën në të cilën vlerësimi është rishikuar si dhe në periudhat e ardhshme që preken.

Në veçanti, informacion mbi fushat më të rëndësishme të vlerësimeve të pasigurisë dhe gjykimeve kritike në aplikimin e politikave kontabël të cilat kanë efektet më të rëndësishme në shumat e njohura në pasqyrat financiare, janë përshkruar në shënimet përkatëse të pasqyrave financiare. Përdorimi i



vlerësimeve kontabël është minimal në këto pasqyra financiare duke patur parasysh thjeshtësinë e veprimeve të realizuara nga Shoqëria.

3. POLITIKAT KONTABËL

Politikat kontabël të mëposhtme janë aplikuar në mënyrë konsistente për të gjitha periudhat e paraqitura në këto pasqyra financiare.

3.1 Transaksionet në monedhë të huaj

Transaksionet në monedhë të huaj konvertohen në monedhën funksionale (Lek) me kursin e këmbimit në datën e transaksionit. Aktivitet dhe detyrimet monetare në monedhë të huaj në datën e bilancit janë konvertuar në Lek, me kursin e këmbimit të asaj date. Fitimi ose humbja në monedhë të huaj në zërat monetarë është diferenca që rezulton nga konvertimi i një numri të caktuar njësisish në monedhë të huaj në Lek me kurse të ndryshme këmbimi. Aktivitet dhe pasivet jo monetare në monedhë të huaj janë konvertuar në Lek me kursin e këmbimit të datës së transaksionit, ndërsa ato që janë matur me vlerë të drejtë janë konvertuar në Lek me kursin në datën kur është përcaktuar vlera e drejtë. Diferencat në monedhë të huaj që vijnë nga konvertimi në Lek janë njohur në pasqyrën e performancës.

Kursi zyrtar i këmbimit i Bankës së Shqipërisë për 31 dhjetor 2022 dhe 2021 ka qënë si më poshtë

| | 30 dhjetor 2022 | 31 dhjetor 2021 |
|--------------|-----------------|-----------------|
| Euro (EUR) | 114.23 | 120.76 |
| Dollar (USD) | 107.05 | 106.54 |

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.2 Instrumenta financiarë

Instrumentat financiarë jo – derivativë përbëhen nga llogaritë e arkëtueshme, para ja dhe mjetet monetare dhe llogaritë të pagueshme.

Instrumentat financiarë që përmbajnë një detyrim dhe element kapitali njihen ose si detyrime ose si kapital. Shoqëria ka klasifikuar si detyrim çdo hua të konvertueshme të marrë.

Instrumentat financiarë jo – derivativë njihen fillimisht me vlerën e drejtë plus, për instrumentat e mbajtur jo në vlerën e drejtë nëpërmjet çdo kosto transaksioni që lidhet me to, përveç siç përshkruhet më poshtë. Në vijim të njohjes fillestare instrumentat financiar jo-derivativë maten siç përshkruhet më poshtë.

Një instrument financiar njihet nëse Shoqëria bëhet palë në kushtet kontraktuale të instrumentit. Aktivitet financiarë ç'rregjistrohen kur skadojnë të drejtat kontraktuale të Shoqërisë mbi fluksin e mjeteve monetare të aktivitet financiar ose kur Shoqëria transferon aktivin financiar te një palë e tretë pa mbajtur kontrollin ose gjithë rreziqet dhe përfitimet thelbësore të aktivitet. Blerjet dhe shitjet normale të aktiveve financiare kontabilizohen në datën e transaksionit, që është data në të cilën Shoqëria angazhohet të blejë apo të shesë aktivin. Detyrimet financiare ç'rregjistrohen nëse detyrimet kontraktuale të Shoqërisë skadojnë, shfuqizohen ose anulohen.

Llogaritë e arkëtueshme

Llogaritë e arkëtueshme njihen fillimisht me vlerën e drejtë dhe më pas me kosto të amortizuar duke zbritur humbjen nga zhvlerësimi. Provigjoni për zhvlerësimin e aktiveve të arkëtueshme llogaritet kur ka të dhëna se Shoqëria nuk do të jetë në gjendje të mbledhë të gjitha detyrimet. Vështirësitë

financiare të debitorit, mundësia që debitori të falimentojë ose riorganizimi i tij financiar si dhe vonesa në pagesa, konsiderohen si tregues që llogaritë e arkëtueshme janë zhvlerësuar.

Shuma e provigjionit llogaritet si diferencë midis vlerës së mbetur dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Mjetet monetare

Mjetet monetare përfshijnë arkën, llogaritë rrjedhëse dhe depozitat afatshkurtra me bankat. Për qëllimin e pasqyrës së rrjedhës së parasë, paraja dhe ekuivalentet e saj përfshijnë depozita me një maturim prej tre muajsh ose më pak që nga data e fillimit.

Llogaritë e pagueshme

Llogaritë e pagueshme paraqiten me kosto.

Kreditë dhe huatë

Kreditë dhe huatë rregjistrohen me shumat neto të marra. Çdo zbritje, prim apo diferenca të tjera midis të ardhurave neto dhe vlerës së rimarrjes amortizohen dhe përfshihen në koston financiare të kredisë të shpërndarë gjatë kohëzgjatjes së kredisë. Shpenzimet e interesit mbi kreditë llogariten në bazat e parimit të së drejtës së konstatuar. Kostot e huamarrjes rregjistrohen si shpenzime kur ato ndodhin.

Vlera e drejtë

Vlerat e drejta të përlllogaritura të parasë dhe ekuivalenteve të saj, llogarive të arkëtueshme dhe të pagueshme, dhe huave janë të ngjashme me vlerat e tyre kontabël neto për shkak të maturimit afatshkurtër ose normave të interesit të cilat i përafrohen normave të tregut.

3. POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.3 Aktivet afatgjata materiale

i. Njohja dhe matja

Të gjitha aktivet afatgjata materiale paraqiten me kosto duke zbritur amortizimin e akumuluar dhe humbjen nga rënia në vlerë. Kostoja përfshin shpenzimet të cilat lidhen drejtpërdrejt me blerjen e aktivit. Kosto e aktiveve të vetë ndërtuara përfshin koston e blerjeve të materialeve, punën dhe çdo kosto tjetër që ka për synim të sjellë aktivet në kushte pune, koston e çmontimit dhe heqjen e elementëve, rregullimin e vendit në të cilin ato janë vendosur si dhe kostot e kapitalizuara të huamarrjes. Programi i blerë, i cili është i rëndësishëm në funksionimin e pajisjes së lidhur me të është kapitalizuar si pjesë e asaj pajisjeje.


Kur pjesë të aktivit kanë kohëzgjatje të ndryshme ato kontabilizohen si aktive më vete (përbërësit më të mëdhenj) të grupit të aktiveve afatgjata materiale.

Fitimet dhe humbjet nga nxjerrja jashtë përdorimit e një aktivit afatgjatë material përcaktohen në bazë të krahasimit midis të ardhurave nga nxjerrja jashtë përdorimit dhe vlerës së mbartur dhe këto fitime apo humbje njihen neto në pasqyrën e performancës.

ii. Kostot vijuese

Kosto e pjesës zëvendësuese të një elementi të aktiveve afatgjata materiale njihet në vlerën e mbartur në qoftë se ka probabilitet që përfitimet ekonomike në të ardhmen do të gjenerohen nga ky aktiv dhe do të rrjedhin në Shoqëri, si dhe kosto e kësaj pjesë të jetë e matshme në mënyrë të besueshme. Kostot e shërbimeve të përditshme të pajisjeve dhe makinerive njihen në pasqyrën e të ardhurave kur ato ndodhin.

iii. Amortizimi



Amortizimi i makinerive dhe pajisjeve llogaritet duke përdorur metodën e vlerës së mbetur mbi jetën e çdo pjese të një aktivi që nga dita e parë e muajit që pason muajin në të cilin ai është blerë.

Aktivitet e dhëna me qira amortizohen përgjatë periudhës më të shkurtër midis kohës së dhënies me qira dhe jetëgjatësisë së tyre. Toka nuk amortizohet.

Të gjitha aktivitet materiale të Shoqërisë amortizohen me vlerën e mbetur dhe vetëm aktivitet jo materiale amortizohen me metodën lineare. Toka dhe shtëpitë e banimit (përfshirë shtojcat) nuk amortizohen. Normat vjetore të amortizimit janë si më poshtë:

| | <i>Në %</i> |
|---|-------------|
| Ndërtesat, konstruksione, makineri | 5 |
| Mjete transporti, pajisje dhe instalime | 20 |
| Pajisje të tjera | 20 |
| Pajisje kompjuterike | 25 |

3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.4 Zhvlerësimi

i. Aktivitet financiare

Një aktiv financiar konsiderohet i zhvlerësuar nëse ka të dhëna objektive që tregojnë se një apo disa ngjarje kanë efekte negative në flukset e ardhshme që parashikohet të burojnë nga aktivi dhe kur kjo mund të vlerësohet me besueshmëri.

Një zhvlerësim në lidhje me aktivin financiar, të matur me kosto të amortizuara, llogaritet si diferencë midis vlerës së mbartur dhe vlerës aktuale të rrjedhjeve të ardhshme të parashikuara të parasë të skontuara me normën efektive të interesit.

Aktivitet financiare të rëndësishme individualisht testohen për zhvlerësim në mënyrë individuale. Aktivitet e tjera financiare vlerësohen në mënyrë të grupuar, në grupe që kanë karakteristika të ngjashme të rrezikut të kredisë.

Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

Një humbje nga zhvlerësimi rimerret nëse rimarrja mund të lidhet objektivisht me një ngjarje të ndodhur pas njohjes së humbjes nga zhvlerësimi. Për aktivitet financiare të matura me kosto të amortizuara, rimarrja njihet në pasqyrën e performancës.

ii. Aktivitet jo financiare

Vlera e mbetur e aktiveve jo financiare të Shoqërisë, rishikohet në çdo datë raportimi për të përcaktuar nëse ka të dhëna për zhvlerësim. Nëse ka të dhëna të tilla, atëherë vlerësohet vlera e rikuperueshme e aktivitet. Shuma e rikuperueshme është vlera më e lartë ndërmjet vlerës së drejtë minus kostot e shitjes dhe vlerës në përdorim. Në vlerësimin e vlerës në përdorim, rrjedhja e pritshme e ardhshme e parasë është skontuar në vlerën aktuale duke përdorur normën e skontimit që reflekton vlerën aktuale të parasë në treg dhe rreziqet specifike të aktivitet për të cilat vlerësimet e rrjedhjeve të ardhshme të parasë nuk janë rregulluar.

Një humbje nga zhvlerësimi njihet nëse vlera e mbetur e një aktivi tejkalon vlerën e tij të rikuperueshme. Humbjet nga zhvlerësimi njihen në pasqyrën e performancës.

3.5 Provigjonet

Një provigjon njihet nëse, si rezultat i një ngjarje të shkuar, Shoqëria ka një detyrim ligjor apo të kushtëuar, i cili mund të vlerësohet në mënyrë të besueshme dhe ka mundësi që në të ardhmen do të duhen rrjedha dalëse parash për shlyerjen e tij.


3.6 Njohja e të ardhurave

Të ardhurat përbëhen kryesisht nga tarifat fikse të magazinimit dhe trajtimit për periudha kohe të rëna dakord midis palëve. Kontratat janë përgjithësisht afatgjata dhe tarifat janë objekt rregullimi vjetor për inflacionin. Të ardhurat nga një kontratë magazinimi për sigurimin e shërbimeve njihen gjatë kohëzgjatjes së kontratës me metodën lineare.

3.7 Të ardhurat dhe shpenzimet financiare

Të ardhurat financiare përfshijnë të ardhurat nga interesi nga fondet e investuara në depozitat bankare dhe fitimet nga transaksionet në monedhë të huaj. Të ardhurat nga interesi njihen kur ato konstatohen.

Shpenzimet financiare përfshijnë shpenzimet financiare nga huamarrjet, humbjet në monedhë të huaj dhe ndryshimet në vlerën e drejtë të aktiveve financiare përmes fitimit apo humbjes në vlerë të drejtë (nëse ka). Të gjitha kostot e huamarrjes njihen në pasqyrën e performancës kur ato ndodhin.



3 POLITIKAT KONTABËL (VAZHDIM)

3.8 Tatimi mbi fitimin

Shpenzimi i tatimit mbi fitimin përfshin tatimin e vitit, i cili njihet drejtpërdrejt në pasqyrën e performancës. Tatimi i vitit është tatimi i pritshëm për t'u paguar mbi të ardhurat e tatueshme të vitit, duke përdorur normat tatimore në fuqi në datën e raportimit.

3.9 Kostot e huamarrjes

Kostot e huamarrjes që lidhen drejtpërdrejt me blerjen, ndërtimin ose prodhimin e aktiveve të kualifikuara, të cilat janë aktive që domosdoshmërisht kërkojnë shumë kohë për të qënë gati për përdorim ose shitje, i shtohen kostos së këtyre aktiveve, derisa këto aktive të jenë gati për përdorim ose shitje.

4 MJETET MONETARE


Mjetet monetare më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 janë si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2022 | Më 31 dhjetor 2021 |
|-----------------------|--------------------|--------------------|
| Banka rezidente /Euro | 0 | 0 |
| Banka rezidente /USD | 0 | 0 |
| Banka rezidente /Lek | 36.531.311 | 0 |
| Banka rezidente / GBP | 0 | 0 |
| Arka | 0 | 0 |
| TOTALI | 36.531.311 | 0 |

5 TË DREJTA TË ARKËTUESHME

Të drejtat e arkëtueshme më 31 dhjetor 2022 dhe 2021 përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2022 | Më 31 dhjetor 2021 |
|---|--------------------|--------------------|
| Llogari të arkëtueshme, neto | 0 | 0 |
| Të drejta nga njesite ekonomike brenda grupit | 29.177.448 | 0 |
| Tatimi mbi fitimin | - | - |
| Të arkëtueshme nga shteti: TVSH e zbritshme | 239.637 | 0 |
| Garanci | 0 | - |
| Hua punonjes/paleve te treta | 0 | 0 |
| Kapital i nenshkuar i papaguar | 4.900.000 | 0 |
| TOTALI | 34.317.085 | 0 |
| Llogari të arkëtueshme, neto | 34.317.085 | 0 |



6 INVENTARI

Inventari më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 përbëhet si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2022 | Më 31 dhjetor 2021 |
|-------------------------|--------------------|--------------------|
| Mallra | 233.359.461 | 0 |
| Parapagime per inventar | 0 | 0 |
| TOTALI | 233.359.461 | 0 |

Bazuar në marrëveshjen e transferimit të nënshkruar ndërmjet secilës shoqëri transferuese me shoqërinë pritëse [Shoqëria Rajonale Ujësjetllës Kanalizime Elbasan sha], inventarët janë transferuar fizikisht në datën e mbylljes së pasqyrave financiare dhe janë dokumentuar nëpërmjet lëshimit të faturave tatimore të fiskalizuara nga çdo njësi si dhe raportimit të tyre në pasqyrat financiare të mbyllura për vitin ushtrimor 2022. Deri në datën e mbylljes së pasqyrave financiare faturat e fiskalizuara janë në shumën gjithsej 221,670,175 lekë, diferenca në shumën 11,689,286 lekë do të dokumentohet me lëshimin e faturave tatimore të fiskalizuara gjatë vitit 2023 për të saktësuar përfundimisht inventarin e transferuar fizikisht në datë 31 dhjetor 2022.

7 SHPENZIME TE SHTYRA


Shpenzimet e shtyra më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 përbëhet si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2022 | Më 31 dhjetor 2021 |
|-----------------------------------|--------------------|--------------------|
| Shpenzime te periudhave te ardhme | 0 | 0 |
| TOTALI | 0 | 0 |

8 AKTIVE FINANCIARE – TITUJ TE TJERE TE HUADHENIES

Tituj te tjere te huadhenies për vitin 2022 dhe 2021 i referohet .:

| | Më 31 dhjetor 2022 | Më 31 dhjetor 2021 |
|--|--------------------|--------------------|
| Tituj Pronesie ne njesite ekonomike brenda grupit | 0 | 0 |
| Tituj te huadhenies ne njesite ekonomike brenda grupit | 0 | 0 |
| Tituj te tjere te huadhenies | 0 | - |
| TOTALI | 0 | 0 |



9 AKTIVE AFATGJATA MATERIALE DHE JOMATERIALE

Aktivet afatgjata materiale më 31 dhjetor 2022 përbehen si më poshtë:

| | Toka dhe ndërtesa | Impiante makineri | Te tjera instalime dhe pajisje | Aktive te tjera | Totali |
|-------------------------------|----------------------|----------------------|-----------------------------------|-------------------|----------------------|
| Vlera neto | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2021 | - | - | - | - | - |
| Shtesa | 1.688.290.995 | 2.445.052.337 | 27.534.428 | 45.080.640 | 4.205.958.401 |
| Pakësime | - | - | - | - | 0 |
| Gjendja më 31 dhjetor 2022 | 1.688.290.996 | 2.445.052.337 | 27.534.428 | 45.080.640 | 4.205.958.401 |
| Amortizimi | | | | | |
| Gjendja më 31 dhjetor 202x | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |
| Vlera kontabël neto | | | | | |
| 31 dhjetor 202x | 0 | 0 | 0 | 0 | 0 |



10 DETYRIME TË TJERA AFATSHKURTRA

Detyrime të tjera më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 përbëhen si më poshtë:

| | Më 31 dhjetor 2022 | Më 31 dhjetor 2021 |
|---|--------------------|--------------------|
| Titujt e huamarrjes | 0 | 0 |
| Detyrime ndaj institucioneve të kredise | 0 | 0 |
| Arketime në avance për porosi | 6.976 | 0 |
| Te pagueshme për aktivitetin e shfrytëzimit | 368 | 0 |
| Te pagueshme ndaj njesive ekonomike brenda grupit | 0 | 0 |
| Te pagueshme ndaj punonjësve | | 0 |
| Detyrime ndaj shtetit: Sigurime shoqërore | 189.655 | 0 |
| TOTALI | 196.999 | 0 |

- Shuma 6.976 leke janë likuidime të kliente-ve të UK-ve ekzistuese të paguara në llogarinë e re të SHRUKË. Janë klasifikuar si detyrime afatshkurtra, pasi me dorëzimin e Raportit të Transferimit të Veprimtarisë Ekonomike, do kalohen si arketime nga klientet përkatës.
- Shuma 368 leke është detyrime ndaj Posta Shqiptare sh.a..
- Shuma 189.655 leke është detyrimi për sigurimet shoqërore dhe shëndetësore dhe TAP për muajin Dhjetor 2022 i cili është paguar në muajin Janar 2023.

11 DETYRIME TË TJERA AFATGJATA

Detyrimet e tjera afatgjata në shumën 4.503.256.260 leke i përket kontributeve në vlerë monetare dhe me transferim Aktivesh Afatgjata sipas listës më poshtë:

- 30.000.000 leke fond për performancën e UK-ve ekzistuese dhënë nga AKUM
 - 3.960.000 leke fond për pagesën ndaj Ekspertit për procesin e Transferimit të Veprimtarisë ekonomike
 - 2.535.119.881 leke nga UK Elbasan (2.526.634.885 leke aktive + 8.484.996 leke mjete monetare)
 - 174.452.007 leke nga UK Belsh (173.040.427 leke aktive + 1.411.580 leke mjete monetare)
 - 424.322.400 leke UK Cerrik (422.782.689 leke aktive + 1.185.594 leke mjete monetare)
 - 161.334.895 leke UK Gramsh (154.665.101 leke aktive + 6.669.794 leke mjete monetare)
 - 1.072.700.225 leke UK Librazhd (1.060.266.788 leke aktive + 12.433.437 leke mjete monetare)
 - 101.366.854 leke UK Peqin (101.366.854 leke aktive)
-
- 4.503.256.260 leke



12 KAPITALI AKSIONAR

Kapitali i nenshkruar i Shoqerise Rajonale Ujesjelles Kanalizime Elbasan sha eshte 10.000.000 leke

Kapitali i Shoqerise eshte i perbere nga:

- 51% Ministria e Infastrukturës dhe Energjisë
- 5.46% Bashkia Cerrik
- 4.13% Bashkia Gramsh
- 28.52% Bashkia Elbasan
- 3.34% Bashkia Peqin
- 4.42% Bashkia Belsh
- 3.13% Bashkia Librazhd

Humbja per vitin financiare 2022 eshte 2.297.002 leke.

Më 31 Dhjetor 2022, kapitali aksionar është 7.702.998 Lek

13 TË ARDHURA NGA AKTIVITETI I SHFRYTËZIMIT

Të ardhurat nga aktiviteti i shfrytëzimit për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 dhe 31 dhjetor 2021 paraqiten si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|----------------------------------|---|---|
| Te ardhura nga shitja e mallrave | 0 | 0 |
| Te ardhura te tjera | 0 | - |
| TOTALI | 0 | 0 |

14 LENDE E PARE DHE MATERIALE TE KONSUMUESHME

Shpenzimet per lende te pare dhe mallrat e tjera per rishitje

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|---------------------------------------|---|---|
| Blerje/Shpenzime mallrash, shërbimesh | 0 | 0 |
| Te tjera shpenzime | 0 | 0 |
| TOTALI | 0 | 0 |

15 SHPENZIME PERSONELI

Shpenzime personeli përbëhet nga pagat dhe kontributet për sigurimet shoqërore dhe shëndetsore:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|---------------------------------------|---|---|
| Shpenzime për pagat | 1.446.667 | 0 |
| Kontribute shoqërore dhe shëndetësore | 219.073 | 0 |



| | | |
|---------------|------------------|----------|
| TOTALI | <u>1.665.740</u> | <u>0</u> |
|---------------|------------------|----------|

16 SHPENZIME TË TJERA

Shpenzime të tjera përbëhen si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|------------------------------------|---|---|
| Amortizimi | 0 | 0 |
| Shpenzime te tjera te shfrytezimit | <u>600.071</u> | <u>0</u> |
| TOTALI | <u>600.071</u> | <u>0</u> |

Ne zerin shpenzime te tjera te shfrytezimit perfshihen shpenzimet si me poshte :

Noteriale, Postare, Kancelarike, Certificate Elektronike, Anetaret dhe sekretar Keshilli, Komisionet bankare, Tatim ne burim, Komisione bankare, Taksa dhe tarifa vendore, gjoba.

17 TE ARDHURA TE TJERA


Te ardhurat nga kursi ikembimit janë detajuar si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|----------------------------------|---|---|
| Te ardhurat nga kursi i kembimit | <u>0</u> | <u>0</u> |
| Te ardhura nga interesi | <u>12</u> | |
| TOTALI | <u>12</u> | <u>0</u> |

18 SHPENZIME TE INTERESI DHE SHPENZIME TE NGJASHME

Shpenzime nga interesat dhe nga kursi i kembimit janë detajuar si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|------------------------------|---|---|
| Shpenzime interesi | <u>0</u> | <u>0</u> |
| Humbje nga kembimet valutore | 0 | 0 |
| Zbritje akorduar klienteve | <u>0</u> | <u>0</u> |
| TOTALI | <u>0</u> | <u>0</u> |



19 SHPENZIME TE TJERA FINANCIARE

Shpenzime nga interesat dhe nga kursi i kembimit janë detajuar si më poshtë:

| | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2022 | Për vitin e mbyllur më 31 dhjetor 2021 |
|---------------------------------|---|---|
| Shpenzime per sherbimet bankare | 31.203 | 0 |
| TOTALI | 31.203 | 0 |

20 TATIM FITIMI

Shoqëria është subjekt i tatim fitimit në Shqipëri; norma e tatim fitimit është 15% për vitin 2022. Deklaratat tatimore dorëzohen çdo vit, por të ardhurat dhe shpenzimet e deklaruar për qëllime tatimore konsiderohen vetëdeklarime deri në momentin që autoritetet tatimore shqyrtojnë deklaratat dhe rregjistrimet e tatimpaguesit dhe lëshojnë vlerësimin final. Ligjet dhe rregullat tatimore shqiptare janë objekt interpretimi nga autoritetet tatimore.

Përlllogaritja e normës efektive të tatim fitimit për vitin 2022

| | |
|---|--------------------|
| Totali i te ardhurave nga aktiviteti | 0 |
| Totali i shpenzimeve nga aktiviteti | 0 |
| Fitimi Kontabel | (2.297.016) |
| Shpenzimet e pazbritshme | (10.000) |
| Fitimi Tatimor | 0 |
| Tatim fitimi i llogaritur | 0 |
| Fitimi Neto | 0 |
| Parapagimet tatimi mbi fitimin viti 2022 | 0 |
| Detyrimi per tu paguar | 0 |

21 ANGAZHIME DHE PASIGURI

Çështje gjyqësore të tjera

Gjatë aktivitetit normal, Shoqëria mund të përfshihet në procedura ligjore, padi dhe çështje gjyqësore me palë të treta. Drejtimi beson se çdo ngjarje e mundshme në të ardhmen nuk do të ketë efekt negativ material në pozicionin financiar të Shoqërisë, në rezultatin apo në fluksin e mjeteve monetar.

22 NGJARJE PAS DATËS SË RAPORTIMIT

Nuk ka ndodhur asnjë ngjarje pas datës së raportimit që do të kërkonte rregullime apo shpjegime të mëtejshme në këto pasqyra financiare.

Hartoi:

Enea Paheshti

